



# INDEKSI I TRANSPARENCËS NË PROKURIMIN PUBLIK

RAPORT MBI PUBLIKIMIN E DOKUMENTEVE  
TË PROKURIMIT PUBLIK NGA KABINETI QEVERITAR

Mars 2015, Prishtinë





# INDEKSI I TRANSPARENCËS NË PROKURIMIN PUBLIK

RAPORT MBI PUBLIKIMIN E DOKUMENTEVE  
TË PROKURIMIT PUBLIK NGA KABINETI QEVERITAR

Mars 2015, Prishtinë



Ky raport financohet nga Ambasada Britanike në Prishtinë, si pjesë e projektit “Transparenca dhe Llogaridhënia në Prokurimin Publik në Komuna”. Ky projekt ka për qëllim që të rrisë transparencën dhe rregullsinë e proceseve të prokurimit në nivelin lokal në Kosovë, përmes fuqizimit të OJQ-ve lokale për monitorimin e procedurave të prokurimit publik.

Qëndrimet në këtë raport janë të KDI/TIK dhe jo detyrimisht korrespondojnë me qëndrimet e donatorit.



British Embassy  
Pristina

## Përmbajtja

Hyrje .....	4
Metodologjia.....	4
Transparenca në prokurim publik .....	5
Qasja në dokumente publike.....	5
Konkluzione .....	7
Transparenca buxhetore .....	7
Konkluzione .....	10
Transparenca në tenderim .....	10
Konkluzione .....	11
Ankandet publike.....	12
Konkluzione .....	12
Ankesat në OSHP .....	13
Konkluzione .....	14
Ministritë më transparente .....	16
Aneks i Raportit .....	16
Testimi i qasjes në dokumente dhe informata zyrtare për institucionet Qeveritare.....	16

## Hyrje

Shpenzimet e fondeve publike përmes prokurimit publik në Kosovë janë në masë të madhe të mbyllura për publikun dhe si rezultat nuk ka mbikëqyrje të duhur nga shoqëria civile, media dhe vetë publiku. Për këtë arsye Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) / Transparency International Kosova (TIK) është angazhuar që të përgatisë këtë Indeks të Transparencës në Prokurimin Publik. Kjo është bërë përmes krahasimit dhe matjes së qasjes në dokumente publike, transparencës buxhetore, transparencës në prokurim, transparencës në ankande publike dhe ankesave në OSHP. Synimi i këtij indeksi është që të bëhet presion tek institucionet qendrore që të ofrojnë transparencë më të lartë dhe qeverisje më të hapur. Qasja në informacion lidhur me shpenzimet publike përmes prokurimit publik do t'i mundësonte publikut të njihen më mirë se ku shkojnë taksat e tyre. Njëkohësisht transparenca më e madhe parandalon parregullsitë, keq-menaxhimin dhe korrupsionin në këto institucione.

## Metodologjia

Matja e transparencës në prokurim publik ka një rëndësi të shtuar pasi që ky sektor është një nga pikat më të ndjeshme përmes të cilit supozohet se keq menaxhohen apo keqpërdoren paratë publike. KDI dhe TIK ka zhvilluar një metodologji të re, të matjes së transparencës në prokurimin publik. Ky indeks është i pari me radhë për Qeverinë e Kosovës, dhe ka për qëllim të masë nivelin e transparencës së ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit në prokurimin publik. Në dhjetor të vitit 2014 KDI dhe TIK ka përgatitur një indeks të njëjtë për nivelin lokal, duke matur nivelin e transparencës se komunave në shtylla dhe indikatorë konkret.

Indeksi i Transparencës në Prokurimin Publik, ka pesë shtylla me gjithsejtë 23 indikatorë. Përmes këtij indeksi institucionet janë matur dhe krahasuar në shtyllat në vijim: 1. Qasjen në dokumente publike; 2. Transparencën buxhetore; 3. Transparencën në prokurim; 4. Transparencën në ankande publike; dhe, 5. Ankesat në OSHP. Matja për këta indikatorë është bërë për tërë të vitin 2014. Këto të dhëna janë marr nga tre burime, (1) ueb faqet e institucioneve, (2) kërkesat për qasje në dokumente zyrtare dhe (3) ueb faqja e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

## Transparenca në prokurim publik

### Qasja në dokumente publike


Nga pesë shtyllat e matura në këtë indeks të transparencës shtylla e parë është qasja në dokumente publike. Qëllimi i matjes së këtyre indikatorëve nuk ka qenë vetëm të shihet se sa po respektohet Ligji për Qasje në Dokumente Publike, por edhe për të parë se sa qytetarët, organizatat e shoqërisë civile apo edhe mediat e shfrytëzojnë këtë mekanizëm për të kërkuar llogari nga institucionet qeveritare. Vëmendje kryesore i është kushtuar kërkesave për qasje në dokumente publike që lidhen me prokurimin publik.

Sipas të dhënave tona 19 ministrive të Qeverisë së Kosovës së bashku edhe me Zyrën e Kryeministrit (ZKM), në total i janë parashtruar 239 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare. Sipas të dhënave që institucionet kanë ofruar mbi qasjen në dokumente zyrtare, nga ky numër i kërkesave, 64 ishin kërkesa që lidhen me dokumente të procedurave të prokurimit publik. Në anën tjetër institucionet kanë refuzuar 9 kërkesa për qasje në dokumente publike dhe asnjë nga këto të dokumente nuk kishte të bënte me prokurimin publik. Nga këto të dhëna nuk janë të përfshira Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të cilat nuk kanë ofruar të dhënat e tyre në lidhje me këtë indeks duke injoruar kërkesat për qasje në dokumente dhe informata zyrtare.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), është institucioni të cilit i janë adresuar më së shumti kërkesa për qasje në dokumente zyrtare me 33 kërkesa. Nga ky numër i kërkesa, vetëm shtatë (7) kishin të bënin me dokumente të prokurimit publik. Në anën tjetër, kjo Ministri përcillet shumë afër nga Ministria e Shëndetësisë (MSH) e cila ka pasur 30 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, prej të cilave 16 kishin të bënin me prokurimin publik. Krahasuar me MTI, MSH ka pasur numër më të madh të kërkesave për dokumente që lidhen me prokurimin publik. Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), ka pasur numrin më të vogël të kërkesave, apo më mirë thënë nuk kanë pasur asnjë kërkesë për qasje në dokumente dhe as për dokumente të prokurimit publik.

Institucioni me numrin më të madh të kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike është ZKM, e cila nga 19 kërkesa për qasje në dokumente ka refuzuar pesë (5). Institucionet e tjera që kanë refuzuar qasjen në dokumente publike, janë: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministria e Diasporës, Ministria e Drejtësisë (MD), Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE). Të katër këto ministri kanë refuzuar nga një (1) kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

### Qasja në dokumente zyrtare



## Konkluzione

Institucionet e Kosovës për vitin 2014, kanë pasur një numër shumë të vogël të kërkesave për qasje në dokumente publike. Ky numër i dokumenteve është edhe më i vogël tek kërkesat për dokumente të cilat lidhen me prokurimin publik. Kjo tregon se mediat, shoqëria civile dhe qytetarët gjejnë forma të tjera për të marr dokumente zyrtare dhe nuk preferojnë qasjen përmes kërkesave formale. Për këtë duket se më së shumti ka shërbyer burokracia dhe vonesa në kthimin e përgjigjeve. Për më tepër mungon një institucion ekzekutiv i cili do të shqyrtonte ankesat e qytetarëve për qasje në dokumente dhe i cili do të kishte fuqinë që të detyroj institucionet e Kosovës për të dhënë dokumentet. Aktualisht Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), ka disa kompetenca të tilla, mirëpo ky institucion përveç se nuk ka fuqi për të detyruar një institucion për të dhënë dokumente, gjithashtu ka edhe procedura shumë të gjata të trajtimit të rasteve. Në këtë mënyrë kërkesa formale nuk është alternativa më e mirë për të marr dokumente publike.

Në përgjithësi ministrinë e Qeverisë së Kosovës, nuk kanë refuzuar shumë dokumente zyrtare. Dy institucionet e vetme të pa përgjegjshme në këtë rast, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, prijnë për nga mos respektimi i dispozitave ligjore dhe kushtetuese për qasje në dokumente, pasi që për më tepër se dy (2) muaj nuk i janë përgjigjur kërkesave tona për të dhënë informata lidhur me këtë indeks. Ministria e Infrastrukturës edhe në të kaluarën ka mohuar qasjen në dokumente, madje deri në shtatë (7) muaj vonesë.

## Transparenca buxhetore

Në këtë shtyllë KDI ka matur transparencën buxhetore të dikastereve qeveritare e cila domosdoshmërisht lidhet edhe me prokurimin publik. Në këtë kuptim bizneset dhe qytetarët duhet të kenë njohuritë e duhura për procedurat tenderuese të cilat do t'i zhvillojnë institucionet qeveritare apo edhe ato të cilat planifikon t'i bëjnë. Në këtë shtyllë ne kemi matur se sa ministrinë publikojnë buxhetin, planin e prokurimit, raportet e auditimit, dëgjimet buxhetore dhe raportet financiare.

Një ndër dokumentet më të rëndësishme të secilit institucion është buxheti me të cilin menaxhon secila ministri apo departament qeveritar. Në Kosovë, Ministria e Financave (MF) publikon të dhëna të përgjithshme buxhetore të përmbledhura për të gjitha institucionet publike në Kosovë. Sidoqoftë ne jemi interesuar të shohim se sa prej ministrive të kabinetit qeveritar, publikojnë të dhëna për buxhetin që kanë në menaxhim. Përmes ueb faqeve të këtyre institucioneve, kemi parë se asnjë ministri dhe as ZKM, nuk publikojnë buxhetet e tyre, me përjashtim të MF e cila publikon çdo vit buxhetin e Kosovës.

Në krahasim me komunat e Kosovës, niveli qendror del shumë më pak transparent. Ashtu sikurse buxheti, rëndësi shumë të madhe ka forma se si janë shpenzuar mjetet financiare. Ne kemi kontrolluar ueb faqet e institucioneve për të parë nëse ato publikojnë raporte të shkruara financiare për mjetet e besuara në menaxhim. Nga 19 ministri dhe ZKM, kemi gjetur se vetëm pesë (5) prej




tyre kanë të publikuar çfarëdo raporti financiar (tre mujor, gjashtë mujor apo vjetorë). Pjesa tjetër e ministrive 14 dhe ZKM nuk kanë publikuar raporte financiare të shkruara në vitin 2014.

Gjithashtu është shikuar edhe publikimi eventual i planeve të prokurimit, dokument ky shumë i rëndësishëm për bizneset, mediat dhe shoqërinë civile, i cili mundëson monitorim të planifikuar të procedurave tenderuese. Përkundër që secili institucion e ka këtë dokument, as edhe një prej institucioneve qeveritare nuk e ka të publikuar këtë dokument në ueb faqe. Publikimi eventual i planit të prokurimit do të ndihmonte bizneset që në mënyrë më të mirë të përgatiteshin për ofertat në tenderët e ardhshëm. Në të njëjtën mënyrë këto institucione nuk publikojnë as raportet e auditimit (brendshëm dhe jashtëm). Asnjë institucion nuk ka të publikuar raporte të auditimit. Këto raporte kanë rëndësi për shkak se japin një vlerësim për formën se si ka menaxhuar institucioni me buxhetin dhe kompetencat e veta. Konsultimet me publikun në lidhje me planifikimet financiare, janë po ashtu të vogla. Vetëm tetë (8) ministri kanë raportuar të kenë mbajtur takime konsultuese me publikun për dëgjime buxhetore.

## Transparenca buxhetore

- Publikimi I buxhetit në ueb faqe
- Plani i prokurimit në ueb faqe
- Raporti i auditorit në ueb faqe
- Nr. I degjimeve publike 2014
- Nr. I raporteve të shpenzimeve financiare 2014




## Konkluzione

Të gjitha ministritë e Qeverisë së Kosovës ZKM, me përjashtim të Ministrisë së Drejtësisë, kanë ushtruar transparencë shumë të ulët buxhetore. Këtyre ministrive u kanë munguar të dhënat elementare buxhetore në ueb faqe, madje mund të thuhet se ueb faqet e ministrive nuk përmbajnë kurrfarë të dhënash financiare. Ministrive u kanë munguar dokumentet si buxheti, raporti financiar, raporti auditimit, plani i prokurimit, konsultimi i publikut për buxhetin.

## Transparenca në tenderim

Në këtë shtyllë është matur transparenca e këtyre institucioneve në prokurim publik. Katër indikatorë janë krahasuar për të parë dallimin e njoftimeve në mes të ueb faqeve të ministrive përkatëse, ZKM-së dhe njoftimeve që këto institucione kanë publikuar në ueb faqen e KRPP-së. Duke pasë parasysh se ueb faqja e KRPP-së i shërben në masë të madhe bizneseve dhe në përgjithësi operatorëve ekonomik, ne kemi dashur të shohim se sa ministritë i publikojnë njoftimet për tender në ueb faqet e tyre. Ky publikim është i rëndësishëm edhe tek tenderët me vlerë më të vogël sesa 10 000 euro, njoftime këto që nuk publikohen në ueb faqet e ministrive apo të ZKM-së.


Numri i tenderëve të publikuar në ueb faqet e ministrive zakonisht dallon shumë për nga numri i tenderëve në ueb faqen e KRPP-së. Kjo për shkak se mos publikimi i tenderit në ueb faqe të KRPP-së mund të ndikojë që procedura të anulohet më pas në tërësi për mos publikim. Megjithëse edhe njoftimet e publikuara në ueb faqen e KRPP-së nuk janë të plota dhe shpesh kanë mangësi serioze në përmbajtje, ato të paktën ofrojnë disa të dhëna në lidhje me procedurën e filluar të prokurimit. Në anën tjetër numri më i madh i ministrive ose nuk e kanë fare pjesën e prokurimit publik në ueb faqe, ose e kanë të pa azhurnuar për një kohë shumë të gjatë.



Nga 653 njoftime të tenderëve të publikuar në ueb faqen e KRPP-së, vetëm 83 prej tyre janë publikuar edhe në ueb faqet e ministrive apo në përqindje vetëm 11% e tenderëve janë publikuar edhe në ueb faqet e ministrive përkatëse. Kjo shifër madje ia kalon edhe mos transparencës së komunave të Kosovës, të cilat kanë publikuar 31% të tenderëve edhe në ueb faqet e tyre.

Këto 83 njoftime për kontratë janë publikuar nga tre (3) ministri të vetme dhe atë kryesisht nga MTI e cila ka publikuar 62 njoftime për kontratë në ueb faqen e saj. Pas saj renditet MD me 19 njoftime për kontratë dhe Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) me dy (2) njoftime për kontratë. Dikasteret tjera qeveritare (16), së bashku edhe me ZKM-në, nuk kanë publikuar as një njoftim për tender në ueb faqet e tyre.

Përqindje e ngjashme e mos publikimit të dokumenteve është edhe në publikimin e njoftimit për dhënien e kontratave (apo njoftimin për fituesit e tenderit). Nga 776 njoftime për dhënie të kontratës që janë publikuar në ueb faqen e KRPP-së, vetëm 63 të tilla janë publikuar edhe në ueb faqet e ministrive. Publikimi i njoftimeve për dhënie të kontratës është dukshëm më i ulët dhe arrijnë në vetëm 8% të numrit të përgjithshëm të tenderëve të publikuar në ueb faqe të ministrive.



Ministritë të cilat kanë publikuar njoftime për dhënie të kontratës gjatë vitit 2014 në ueb faqet e tyre janë: MTI 30 njoftime, Ministria e Integritimit Evropian (MIE) shtatë (7) njoftime, MD 12 njoftime dhe Ministria e Diasporës 14 njoftime.

### Konkluzione

Numri më i madh i departamenteve qeveritare nuk publikojnë në ueb faqet e tyre njoftime për kontratë apo njoftime për dhënie të kontratës. Përmes këtyre dy dokumenteve qytetarët, mediat apo edhe të interesuarit e tjerë mund të shohin se kur një institucion ka shpallur një tender dhe kush janë fituesit e tyre.

## Ankandet publike

Megjithëse krahasuar me procedurat e prokurimit publik, numri i ankandeve është shumë më i vogël dhe artikujt të cilët shiten përmes ankandeve nuk kanë shumë vlera të mëdha, prapë se prapë ne kemi dashur të matim publikimin e njoftimeve për këto ankande. Nga të dhënat e tona del se ankandet po ashtu nuk janë publikuar në ueb faqet e ministrive, e në disa raste as në vet ueb faqen e KRPP-së. Megjithëse është e obligueshme që për këto procedura të ketë njoftime prapë se prapë ministrinë nuk e kanë përfillur këtë kërkesë ligjore.

Përmes ankandeve ministrinë në këtë rast shesin zakonisht mallra të konfiskuara apo edhe pajisje të cilat nuk i përdor më tutje institucioni. Zakonisht veturat apo mobilet janë artikujt më të shpeshtë të cilët shiten përmes ankandeve publike. Sidoqoftë kjo kategori është shumë pak e mbikëqyrur nga institucionet, as Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) dhe as KRPP, nuk i kushtojnë vëmendje apo kontroll ankandeve.

Gjatë vitit 2014, ne kemi vërejtur se numër shumë i vogël i ankandeve janë zhvilluar nga këto institucione. Vetëm dy (2) ankande janë publikuar në ueb faqen e KRPP-së dhe tri (3) të tjera në ueb faqen e MTI-së. Në anën tjetër njoftimet për dhënien e kontratës kemi pasur vetëm dy (2) në ueb faqen e KRPP-së dhe asnjë në ueb faqet e Ministrive. Duket se për këtë kategori të shitjeve në prokurim nuk bëhet ndonjë njoftim i veçantë dhe asetet nuk publikohen para se të shiten, apo thjeshtë ministrinë nuk shesin gjërat e tyre të vjetra mirëpo të njëjtat i lënë në depot e MAP.

Krahasuar me komunat e Kosovës, të cilat vetëm për gjashtë mujorin e pare kanë publikuar mbi 40 njoftime për ankande, ministrinë duket të mos e përdorin këtë mekanizëm për shitjen e aseteve. Institucionet të cilat kanë publikuar të dhëna për ankande janë MTI, ZKM, MAP dhe MKRS.


## Konkluzione

Ankandet ngjashëm me procedurat tjera të prokurimit përcillen me transparencë shumë të ulët, si në njoftime për ankande ashtu edhe për njoftimin në lidhje me fituesit e këtyre ankandeve.

### Ankesat në OSHP

Ankesat në Organin Shqyrtues të Prokurimit, janë një nga indikatorët e matjes së rregullsisë së procesit në një institucion publik. Zakonisht numri i ankesave është më i madh në institucionet të cilat kanë më tepër buxhet, mirëpo këto ankesa japin edhe një pasqyrim për natyrën e shkeljeve të cilat kryejnë institucionet në faza të ndryshme të prokurimit. Në këtë indeks, janë analizuar 137 ankesa të cilat bizneset i kanë bërë kundër ministrive të Qeverisë së Kosovës. Kjo është bërë me qëllimin që të njëjtat të ndahen në disa kategori, për të parë se ku më së tepërmi bëhen shkeljet në procedurat e prokurimit publik. Në këtë indeks, ankesat e bizneseve janë ndarë në: kritere të paqarta, përshtatje e kritereve, vlerësim i padrejtë i ofertave, mohim i qasjes në dokumente të prokurimit publik për bizneset dhe të tjera.

Nga analiza që u është bërë këtyre ankesave për vitin 2014, kundër ministrive dhe ZKM-së, kemi vërejtur se numri më i madh i ankesave 65%, bëhen për fazën e vlerësimit të ofertave. Në këtë proces bizneset ankohen në punën e komisioneve për vlerësimin e ofertave, se u kanë bërë të padrejtë, duke mos i analizuar si duhet dokumentet e tyre.



Bizneset po ashtu shumë shpesh ankohen në OSHP, se institucionet nuk u kanë lejuar qasje në dokumentet dhe ofertat e kompanive të tjera. Zakonisht shumë institucione, duke e shkelur Ligjin e Prokurimit Publik, mbyllin ofertat e kompanive, duke u thirrur në dispozitat e sekretit afarist. Në shumë raste, si sekret afarist po mbyllen edhe ofertat tek çmimet për njësi, gjë e cila është absolutisht e ndaluar me Ligjin e Prokurimit Publik, i cili ka paraparë që çmimet në asnjë rast të mos mund të jenë të mbrojtura si sekrete afariste. Nga analizimi i këtyre ankesave, ne kemi parë se në 8% e tyre, bizneset nuk janë lejuar të shohin ofertat e kompanive të tjera dhe për këtë ata janë ankuar edhe në OSHP.


Probleme bizneset kanë pasur edhe me dosjet e tenderit, përkatësisht kriteret e përcaktuara në këto dosje. Në 10 % të ankesave, bizneset janë ankuar se kriteret ose janë shumë të paqarta dhe nuk mund të përgatisin ofertën e tyre duke u bazuar në këto kritere 6%, ose kriteret kanë qenë shumë specifike dhe të përshtatura për një operator të vetë 4%. Ndërsa 17 % e ankesave nuk kanë pasur të bëjnë me asnjë prej këtyre kategorive. Nga analizimi i këtyre ankesave, vërehet se bizneset përveç në rastet e vlerësimit të ofertave, hezitojnë të parashtrijnë ankesa në OSHP. Kjo mund të interpretohet si mungesë e besimit në këtë institucion apo edhe mungesë e kapaciteteve të kompanive kosovare për t'u marr me anën juridike të tenderëve dhe për t'i kundërshtuar dosjet e tenderëve në OSHP.

Ministritë me numrin më të madh të ankesave kanë qenë: Ministria e Infrastrukturës (MI) me 27 ankesa, e përcjellë nga MKRS me 20 ankesa dhe MSH me 16 ankesa. Ndërkohë që ministritë që kanë pasur më së paku ankesa për procedurat e tyre të prokurimit ishin Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) dhe Ministria e Komuniteteve dhe Kthim (MKK) të cilat nuk kanë asnjë ankesë për vitin 2014. Me vetëm një ankesë në OSHP janë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Diasporës dhe Ministria e Integritimit Evropian (MIE).

## Konkluzione

Prokurimi elektronik në Kosovë do të ndikonte që rreth 90% e këtyre ankesave të mos ekzistonin fare, për shkak se do të shmangte problemet e tilla si vlerësimi i gabuar i ofertave, qasja në dokumente zyrtare dhe do të shmangte kontaktin e drejtpërdrejtë në mes zyrtarëve të prokurimit dhe operatorëve ekonomik.

### Ankesat në OSHP





## Ministritë më transparente

Nga 19 ministri të monitoruara dhe Zyrën e Kryeministrit, kemi ardhur në përfundimin se vetëm dy (2) ministri kanë pasur një shkallë relativisht të mirë të transparencës në financa dhe prokurim publik. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Drejtësisë kanë publikuar të dhëna për prokurimin publik në ueb faqet e tyre. Në fakt Ministria e Drejtësisë e ka publikuar raporte të detajuara financiare javore dhe përkundër disa mungesave të herëpashershme të këtyre raporteve, kjo është një praktikë që duhet vlerësuar dhe e cila do të duhej t'i shërbente si praktikë të gjithë kabinetit qeveritarë. Sidoqoftë, asnjë ministri e kabinetit qeveritar nuk ka qenë mjaftueshëm transparente, bazuar në 23 indikatorët tanë, secila prej tyre ka pasur shumë mungesa në publikimin e dokumenteve.

## Aneks i Raportit

### Testimi i qasjes në dokumente dhe informata zyrtare për institucionet Qeveritare

KDI dhe TIK ka bërë testimin e qasjes në dokumente dhe informacione zyrtare, duke dërguar kërkesa në institucionet përkatëse për të marr informacione dhe dokumente. Nga 20 institucionet e kontaktuara nëntë (9) kanë kthyer përgjigjet brenda afatit shatë (7) ditor, ndërsa nëntë (9) ministri të tjera kanë pasur vonesa nga një (1) deri në 30 ditë. Dy (2) ministri të Qeverisë së Kosovës, MI dhe MASHT, nuk kanë kthyer përgjigje përkundër pritjes prej më shumë se dy muajve për këto kërkesa.

	Institucioni	Data e dërgimit të kërkesës	Data e përgjigjes në kërkesës	Vonesat
1	Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës	16 janar 2015	19 janar 2015	
2	Ministria e Administratës Publike	14 janar 2015	14 janar 2015	
3	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	14 janar 2015	22 janar 2015	1 ditë
4	<b>Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë</b>	14 janar 2015		Nuk ka ofruar qasje
5	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	14 janar 2015	29 janar 2015	8 ditë
6	Ministria e Diasporës	14 janar 2015	16 janar 2015	

7	Ministria e Drejtësisë	14 janar 2015	04 shkurt 2015	14 ditë
8	Ministria e Financave	15 janar 2015	22 janar 2015	
9	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	14 janar 2015	23 janar 2015	2 ditë
10	Ministria e Integritimit Evropian	15 janar 2015	16 janar 2015	
11	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	14 janar 2015	20 janar 2015	
12	Ministria për Komunitete dhe Kthim	15 janar 2015	16 janar 2015	
13	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	14 janar 2015	28 janar 2015	7 ditë
14	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	14 janar 2015	18 shkurt 2015	28 ditë
15	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	15 janar 2015	16 janar 2015	
16	Ministria e Punëve të Brendshme	14 janar 2015	16 janar 2015	
17	Ministria e Punëve të Jashtme	14 janar 2015	20 shkurt 2015	30 ditë
18	Ministria e Shëndetësisë	14 janar 2015	22 janar 2015	1 ditë
19	<b>Ministria e Infrastrukturës</b>	14 janar 2015		Nuk ka ofruar qasje
20	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	14 janar 2015	16 shkurt 2015	26 ditë

